



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.406 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), dega në Ferizaj, për shkak të shpifjeve në tubime publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 31.10.2013, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se subjekti politik LVV dhe kandidati i tyre për kryetar për Komunën e Ferizajit, gjatë fushatës zgjedhore në tubimet publike, si dhe në debatet publike në televizionet lokale dhe qendrore, kanë shpifur dhe nxitur urrejtje ndaj subjektit politik PDK dhe kandidatit për kryetar komune të subjektit politik PDK në Ferizaj, me të cilat deklarata publike sipas parashtruesit të ankesës janë të sanksionuara me ligjin mbi Zgjedhjet Lokale, Rregullën Zgjedhore nr 11/2012 në nenin 4 alineja 4.1(k), Kodin e Procedurës Penale, si dhe Ligjin Civil kundër shpifjes dhe fyerjes.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë materiale linqet nga deklaratimet publike .

PZAP-i, e informoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 31.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.11.2013.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik LVV thekson se parashtruesi i ankesës që pretendon se me një deklaram të tillë, Lëvizja Vetëvendosje dhe kandidati i saj për Kryetar Komune në tubimin e tyre përmbyllës më datë 28.10.2013 në Ferizaj, kanë bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore 11/2012 të KQZ-së, duke marrë parasysh përmbajtjen e dispozitës me të cilën është thirrur parashtruesi i ankesës nuk ka të bëjë në çështjen në fjalë. Po ashtu LVV në përgjigjen e tyre pretendon se asnjë dispozitë e cila është cekur nga parashtruesi i ankesës nuk ka të bëjë me çështjen e parashtruar në ankesë dhe sipas LVV-së në përgjigjen e ofruar thotë se tubimi për të cilin është raportuar është mbajtur me 26 tetor dhe sipas datës së protokolluar në PZAP kjo ankesë nuk mund të jetë e afatshme, andaj kërkojmë nga PZAP-i që gjatë shqyrtimit të ankesës së parashtruar të merr parasysh përgjigjen tonë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se në tubime publike gjatë fushatës zgjedhore subjekti politik LVV me deklarata publike kanë nxitur shpifje dhe urrejtje ndaj subjektit politik PDK, PZAP-i i konsideron se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nga dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi bindëse me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e supozuar. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

Anr. 406/2013 më datën 04.11.2013

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*